



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2018:059655

Datë: 26.08.2020

Numri i dokumentit: 01077723

**P.nr.1004/13**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, në përbërje nga gjyqtari i vetëm gjykues, Hysnije Gashi dhe zyrtaren ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit, J.A, për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni.378 par.9 lidhur me par.6 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1099-3/13 të datës 17.06.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë publik me datë 21.07.2020 në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit, Albert Zejnullahu, të pandehurit J.A, murr dhe shpalli publikisht këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I akuzuari,**

**J.A**, me vendbanim ne fshatin ..., Komuna Ferizaj, i lindur më ..., në Ferizaj, nga i ati N..., e ëma Sh... e gjinisë K..., i martuar, baba i një femije, punon ne moblerin “Sh...”i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJATOR**

Sepse me dt. 03.06.2013, rreth orës 14:10 në rrugën regjionale Doganaj –Ferizaj, derisa ishte duke vozitur veturën e udhëtarëve te markës “Audi 89” ngjyre hiri me targa ..., duke vepruar ne kundërshtim me dispozitat e nenit 54 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka vënë ne rrezik jetën e njerëzve dhe pasurin e tyre, në atë mënyre që derisa ishte duke lëvizur në drejtim të Ferizajt me të arritur te autolarja “U...”duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe te kushteve të rrugës pasi qe ishte vendbanim, humb kontrollin mbi timon dhe del në trotuar dhe

me pjesën e parë të djathtë e godet këmbësorin H.B i cili në ato momente ishte duke lëvizur në trotuar në të njëjtin drejtim ku nga kjo goditje i dëmtuari person lëndime të rënda trupore dhe pas një ore në qendrën emergjente në Ferizaj ndërron jetë.

**- me të cilën ka kryer veprën penale Rrezikimi i Trafikut Publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 të KPK-së**

**Andaj Gjykata në bazë nenit 374 par. 2 dhe neneve 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 43, 49, 50,51, 52, 73, të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-ës, e**

## **G J Y K O N**

**ME DËNIM ME BURGË NË KOHZGJATJE PREJ 6 /gjashtë/ muaj, i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 1.000€ / njëmijë euro/ të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.**

Nëse dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46.3 të KPRK-ës, do të ekzekutohet në atë mënyrë që i pandehuri do të vuaj dënimin si në pikën 1 të këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit Burim Bytyqi nga Ferizaj rruga” Enver Topalli “, për realizimit të kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 55 /pesëdhjetepesë/euro si dhe paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzet/ €, në afatin prej 15 ditësh e nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform neni 39 par. 3 pika 3.1, nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit. Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit ta paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr 1099-3/13 të dt.17.06.2013 e ka ngarkuar të pandehurin J.A, për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni.378 par.9 lidhur me par.6 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësorë më dt. 21.07.2020 në të cilin Prokurori i Shtetit, Albert Zejnullahu në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoi sanksion penal sipas ligjit.

I pandehurit, J.A, në shqyrtimin gjyqësorë në fjalën përfundimtare , me rastin e njoftimit nga gjyqtarja për drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohej i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barrë, ndjej keqardhje për këtë rastë, është i penduar thellë, gjithashtu ka deklaruar se me familjen e të ndjerit janë pajtuar, të ndjerit i kishte dhënë ndihmën pas aksidentit dhe e kishte dërguar vete në spital, i propozoi gjykatës që të shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë.

Gjykata vlerësoi së janë plotësuar kriteret nga neni 326 dhe nenit 248 par. 1 të KPPK-së, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht dhe mbështetet në provat dhe materialet e prezantuara nga prokurori shtetit siç është: mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit i datës 12.06.2013, raporti mjekësorë i datës 03.06.2013. Raporti i autopsisë Nr.ref.DML MA13-136 nëntor 2013

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

-i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit,

-pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,

- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga nenit 378 par.9 lidhur me par. 6 të KPRK-së,

Gjykata, ka konstatuar se ekzistojnë rrethanat lehtësuese, të cilat tregojnë se edhe me dënimin më të butë mund të arrihet qëllimi I dënimit kështu që në kuptim të nenit 75,76 të KPRK-së aplikoi dispozitat për zbutjen e dënimit, Gjykata bëri zbutjen e dënimit duke marrë rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, deri më tani nuk ka qenë asnjëherë i gjykuar, rrethanat e kryerjes së veprës penale ku i akuzuari pas ndodhjes së aksidentit , përpjekja për ti ndihmuar të te ndjerit, kërkim falja publike , sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale ku i akuzuari ka ndier tronditje të thelle për aksidentin dhe pasojat e këtij aksidenti dhe tronditjet shpirtërore i ndjen edhe tash .familja e te ndjerit sipas adeteve dhe traditave ia ka falë fajin për aksidentin e shkaktuar , koha e kryerjes së veprës penale me që nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një kohë relativisht e gjatë . Kështu që konformë nenit 75,76 të KPRK-së, gjykata bëri zbutjen e dënimit nën kufit të minimumit ligjor nga 1 (një )vit burgim si minimum ligjor në 6 ( gjashtë ) muaj burgim , i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 1.000€ / një mijë euro. si rrethane renduese vlerësoi faktin se në këtë aksident kanë humbur jetën një person, bindjen e gjykatëse se ky dënim është plotësisht i justifikueshëm në raport me peshën konkrete të veprës penale, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor që të njëjtit të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit Burim Bytyqi nga Ferizaj rruga” Enver Topalli “, për realizimin të kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 55 /pesëdhjetepesë/euro si dhe paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzet/ €, në afatin prej 15 ditësh e nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform neni 39 par. 3 pika 3.1, nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit. Detyrohet i akuzuari që

për kompensimin e Viktimave të Krimet ta paguaj shumën prej 50€ (tridhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**

**P.nr 1004/13 dt. 05.08.2020**

**Zyrtare ligjore**

Albana Ujupi

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

Hysnije Gashi

**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimet të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.